

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
« KONVERT

KREU I
THEMELIMI, EMRI ,OBJEKTI,SELIA.

NENI I
DATA E THEMELIMIT, THEMELUESIT DHE EMRI

- Sot me date 25.05.2024 eshte krijuar shoqeria me emertimin «Konvert sh.p.k » . e krijuar nga ortakët:

1- Z Sokol Binaj i biri i Luanit i datelindjes 03.07.1985 me banin ne Vlore .

NENI 2 Objekti i veprimtarise

Objekt I aktivitetit ekonomik do te jete :
Konvertimi i monedhave vendase dhe te huaja, berja e transfertave monetare, pagesa e faturave uji, drita, pagesa e gjobave etj.

NENI 3 Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise eshte mbi 10 vjet

NENI 4
SELIA

Shoqeria **Konvert** SH.P.K. e ka seline e saj ne VLORE , Bulevardi Vlore Skele, “Lgj. Lef Sallata”, ngjitur me Market Conad, kati 0, Vlore.

Ajo ka te drejte te krijoje brenda e jashte teritorit te republikes se Shqiperise filjale , agjensi perfaqesimi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

KAPITALI I REGJISTRUAR

NENI 5

VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TE REGJISTRUAR

VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TE REGJISTRUAR

Vlera e kapitalit te regjistruar te shoqerise “ eshte 2.500.000 leke Indare ne 1 kuote.
Pjasmarrja e ortakeve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre si me poshte
- Sokol BINAJ kuota ose 100 % te kapitalit me vlere te regjistruar 2.500.000 lek

NENI 6

Ortakët kane keto te drejta e detyra themelore:



- te derdhin kuoten e kapitalit baze sikunder eshte parcaktuar ne nenin 5 te ketij akti.
- te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise
- te terheqin fitimin e realizuar
- te terheqin aktivin rezultat nga bilanci i likujdimit ne rast te pushimit te aktivitetit te shoqerise.

- te ruajne sekretin e aktivitetit te shoqerise
- te impenjohen ne arrijten e objektivave te shoqerise

NENI 7

Organet e shoqerise **KONVERT** sh.p.k. jane

- Asambleja e ortakeve

- Administratori

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise.

Administrator i shoqerise « Konvert sh.p.k. eshte znj. Brikela BINAJ e bija e Gezimit, detyra e te cilit fillon me daten 25.05.2024 dhe do te vazhdoje per kater vjet me te drejte rizgjedhje.

dhe do te vazhdoje per kater vjet me te drejte rizgjedhje.

Kjo kontrate eshte perpiluar ne kater kopje

THEMELUESI

SOKOL BINAJ



STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

« Konvert » SH.P.K.
NENI 1 EMERTIMI

Sot me date 25.05.2024 eshte krijuar shoqeria me emertimin «Konvert sh.p.k» sh.p.k. e krijuar nga ortakët:

1- Z Sokol Binaj i biri i Luanit i datelindjes 03.07.1985 me banin ne Vlore .

Shoqeria eshte quajtur « Konvert» sh.p.k.Ajo eshte nje subjekt juridik shqipetar te cilit i lind e drejte te ushtroje aktivitetin qe nga data e rregjistrimit ne rregjistrin tregetar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe pajisjen me leje perkatese nga organet kompetente. Shoqeria « Konvert» sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqipetar .

NENI 2 OBJEKTI

Objekti I aktivitetit ekonomik te shoqerise « Konvert » sh.p.k do te jete :

1 Objekt I aktivitetit ekonomik do te jete :

Konvertimi i monedhave vendase dhe te huaja, berja e transfertave monetare, pagesa e faturave uji, drita, pagesa e gjobave etj.

NENI 3 SELIA

Shoqeria **Konvert** SH.P.K. e ka seline e saj ne VLORE , Bulevardi Vlore Skele, Ngjitur me Market Conad, kati 0, Vlore.

NENI 4

KAPITALI I REGJISTRUAR
VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TE REGJISTRUAR

NENI 5 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise « Konvert » sh.p.k. eshte mbi 10 vjet

NENI 6 TE DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKEVE

Ortakët gezojne keto te drejta e detyra themelore:

-te derdhin kuoten e kapitalit baze sikunder eshte parcaktuar ne nenin 7

-te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise

-te terheqin fitimin e realizuar

- te terheqin aktivin rezultat nga bilanci i likujdimit ne rast te pushimit te aktivitetit te

shoqerise.

-te ruajne sekretin e aktivitetit te shoqerise

-te impenjohen ne arritjen e objektivave te shoqerise



Neni 7: Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të papaguara

(1) Administratorët mund t'u kërkojnë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyera në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

(2) Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

(3) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguaje një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

(4) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorëve dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

(5) Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratorët konsiderojnë të përshtatshme.

(6) Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuotë por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë në datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

Neni 8: Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve,.

Neni 9: Certifikatat e kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Emrat e zotëruesve të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

Neni 10: Kalimi me Kontratë i Kuotave

(1) Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim dhe sipas formaliteteve të përcaktuara nga Administratorët. Kjo kontratë do të dërgohet në selinë e shoqërisë.

(2) Administratorët mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të kuotës në QKR në rast se kjo kuotë nuk është shlyer plotësisht ose në rast se Administratorët nuk janë dakord me personin të cilit i kalon kuota.

(3) Nëse Administratorët refuzojnë të regjistrojnë kalimin e kuotës, ata do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohen kuota, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të kuotës.

Neni 11: Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit



(1) Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.

(2) Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratorët, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.

(3) Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejta që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Neni 12: Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

(1) Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.

(2) Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

Asambleja e Përgjithshme

Neni 13 Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Administratorët thërrasin Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve .

(2) Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara datës së caktuar për mbledhjen .

(3) Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

Neni 14: Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

(1) Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me arritjen e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligji Nr 9901 dt 14.04.2008 “ Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare”. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mjeteve elektronike, përfshirë telekonferencën (conference call), audio ose audio-video, Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme.

(2) Administratorët caktojnë Kryetarin e mbledhjes si edhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.

(3) Nëse asnjë prej Administratorëve nuk dëshiron të caktohet si Kryetar i mbledhjes , ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Administratori, pavarësisht se nuk është ortak, ka të drejtën e pjesëmarrjes si edhe të marrë fjalën në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme.



(5) Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar

rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme.

(6) Asambleja vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultetit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

1. Kryetari; ose

2. një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën pesë për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortakun.

(7) Me përjashtim të kundërshtimit të një ortakut, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marre në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.

(8) Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

Neni 15: Votat e Ortakëve

(1) Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.

(2) Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

(3) Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

Neni 16: Hetimet e posaçme

(1) Personi ose personat që plotësojnë kushtet për të kërkuar emërimin apo zëvendësimin e një eksperti të fushës paraqesin një kërkesë të tillë nëpërmjet depozitimit të një deklarate noteriale në selinë e shoqërisë e cila vërteton se personi ose personat plotësojnë kushtet për kryerjen e këtij veprimi.

Neni 17: Emërimi i Administratorëve

Asambleja e Përgjithshme ka emëruar Administrator të shoqërisë znj. Brikela BINAJi detyra e të cilit fillon me datën 25 MAJ 2024 dhe do të vazhdojë për katër vjet me të drejte rizgjedhje.

Neni 18: Kompetencat e Administratorëve



(1) Politikat tregtare të shoqërisë do të administrohen nga Administratorët të cilët mund të ushtrojnë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme .

(2) Administratorët mund t'ua delegojnë kompetencat e tyre çdo komiteti i cili përbëhet nga një ose më shumë Administratorë. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosin Administratorët dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratorët nuk mund të delegojnë detyrimet e tyre ligjore.

Neni 19: Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorëve

(1) Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator kur asambeja e pergjitheshme ka vendosur shkarkimin e tij
2. personi ndodhet në gjendje paaftësie pagueese;
3. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë,
5. ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e Administratorëve të tjerë në mbledhjet e Administratorëve të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e Administratorëve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

Neni 20: Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorëve

(1) Administratorët shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme .

(2) Administratorëve mund t'iu paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në

lidhje me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e Administratorëve ose të Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre

Neni 21: Mbledhjet e Administratorëve

(1) Mbledhjet e Administratorëve do të mbahen sipas nevojave të aktivitetit tregtar të shoqërisë.

(2) Vendimet e mbledhjes së Administratorëve merren me kuorumin e votave që mund të përcaktohet nga Administratorët, dhe në rast se ky kuorum nuk është përcaktuar ai do të jetë dy.

(3) Asambleja e Përgjithshme cakton njërin prej Administratorëve me detyrën e Kryetarit të mbledhjes së

Administratorëve, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Kryetari do të drejtojë çdo mbledhje të Administratorëve në të cilat ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga ora e caktuar për

mbledhjen, Administratorët e pranishëm mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.

(4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.

(5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e Administratorëve, ose nga një komitet i Administratorëve, apo nga persona të cilët veprojnë si Administratorë, pavarësisht nëse bëhet e ditur më vonë se ka pasur mangësi në emërimin e një Administratori ose njëri prej tyre ka qenë i skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëllë sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si Administratorë dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.

(6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë Administratorët që kanë të drejtë të njoftohen për mbledhjen e Administratorëve ose nga komiteti i Administratorëve do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëllë si të ishte miratuar në mbledhjen e Administratorëve, e mbledhur dhe e zhvilluar rregullisht.

Neni 22: Kufizimet në Votimet e Administratorëve



(1) Administratorët nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Administratorëve për çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, deri në momentin kur në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:

1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje dhe
2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.

Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

(2) Vota e Administratorit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.

(3) Në rast se në mbledhjen e Administratorëve ose të komitetit të Administratorëve diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një Administratori, çështja mund të drejtohet Kryetarit të mbledhjes, përpara përfundimit të mbledhjes, dhe vendimi i tij lidhur me çdo Administrator të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar dhe i formës së prerë.

Neni 23: Procesverbalet e Mbledhjeve të Administratorëve

Administratorët kujdesen që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

1. të gjitha takimeve të kryera nga Administratorët; dhe
2. të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjeve të Administratorëve dhe komiteteve të Administratorëve, përfshirë edhe emrat e Administratorëve të pranishëm në këto mbledhje.

Neni 24: Dividendët

(1) Shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.

(2) Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumën e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë

dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumën e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuota nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë

Neni 25: Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratorët, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash mund të

vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

Neni 26: Prishja dhe likuidimi

Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar të votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.



Neni 27: Njoftimet

(1) Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 13 të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

(2) Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratorët në faqen e internetit të shoqërisë.

Vlore më 25.05.2024

Emrat dhe nënshkrimet e Ortakëve Themelues:

Sokol Binaj Sokol BINAJ

